



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL

(i përmbledhur)¹

Tiranë, më 05.10.2020, ora 13:50

Drejton mbledhjen

Vitore Tusha – zv/Kryetare e Këshillit

Rendi i Ditës:

- 1. Informacioni në lidhje me funksionimin efikas dhe efektiv të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi.*
- 2. Shqyrtimi i gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatin për vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019.*
 - Sergio Mazreku*
 - Sinan Tafaj*
 - Sonila Bejtja*
 - Shaqir Hasanaj*
 - Zhaklina Peto*
- 3. Vendimmarrja lidhur me lejimin/ndalimin e kandidimit të kandidatëve të mësipërm.*

Marrin pjesë:

- | | |
|---------------------|---------------|
| 1. Vitore Tusha | (zv/Kryetare) |
| 2. Fiona Papajorgji | (anëtare) |
| 3. Arta Marku | (anëtare) |

^{1 1} Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja “d”, neni232 pika 2, neni 242 shkronja “c”) dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe të zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

4. Miranda Andoni	(anëtare)
5. Saida Dollani	(anëtare)
6. Fatjona Memcaj	(anëtare)
7. Ludovik Dodaj	(anëtar)
8. Marsida Xhaferllari	(anëtare zëvendësuese)
9. Bilbil Mete	(anëtar zëvendësues)
10. Nazmi Troka	(anëtar zëvendësues)

Merr pjesë, si vëzhgues i përhershëm:

- 1. Avokati i Popullit, përfaqësuar nga z. Enio Haxhimihali.**

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguara në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

- 1. Z. Bledar Dervishaj dhe znj. Katrin Treska,** përfaqësues me autorizim të Presidentit të Republikës së Shqipërisë.
- 2. Znj. Mimoza Arbi,** përfaqësuese me autorizim e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.

Vitore Tusha hap mbledhjen dhe bën me dije rendin e ditës që është publikuar në përputhje me procedurat dhe aktet e miratuara nga Këshilli. Verifikon praninë e anëtarëve dhe pjesëmarrësve në mbledhje. Informon Këshillin se z. Arjan Qafa është drejtuar me e-mail, në të cilin ka shpjeguar se nuk është njoftuar për mbledhjen e sotme në kushtet kur është akoma anëtar i KED-së, duke kërkuar të thirret në mbledhjen e radhës dhe fton anëtarët të shprehin mendimet e tyre në lidhje me këtë. Është e pranishme në këtë mbledhje edhe përfaqësuesja e OPDAT-it, e cila merr pjesë pas kërkesës së saj dhe pas dakordësisë së marrë nga anëtarët e Këshillit për këtë prani.

Informon Këshillin se pas thirrjes së kësaj mbledhjeje është përgatitur dhe përcjellë relacioni për kandidatin që kishte mbetur i papërfshirë në rendin e ditës, z.Eugen Papandile, dhe nga relatorja është sugjeruar që të shtohet në rendin e ditës edhe verifikimi i kësaj kandidature. Shprehet se, duke iu referuar dispozitave të akteve normative të Këshillit, duhet të vlerësohet ky propozim.

Po ashtu, sqaron se procesverbali i mbledhjes së datës 16.09.2020 i përmbledhur iu është shpërndarë të gjithë anëtarëve, të cilët kanë konfirmuar dhe kanë dhënë pëlqimin për të. Edhe pse nuk është përfshirë në rendin e ditës, sepse ditën që u thirr kjo mbledhje nuk ishte i përfunduar, mendon se mund të përfshihet si çështje e parë e rendit të ditës. Fton anëtarët të diskutojnë dhe të miratojnë rendin e ditës.

Anëtarët shprehen se janë dakord me rendin e ditës, si edhe me propozimet për përfshirjen në të edhe të shqyrtimit të kandidaturës së z.Eugen Papandile, si edhe të miratimit të procesverbalit të përmbledhur të datës 16.09.2020.

Enio Haxhimihali shprehet se për sa i përket rendit të ditës, meqenëse materiali ishte voluminoz, për shtesën rezervojnë të drejtën për të dhënë mendimin për këtë kandidat në një kohë të dytë, pasi nuk kanë pasur mundësinë të shqyrtojnë materialet e dosjes së tij.

Vitore Tusha sqaron se edhe pse ka të drejtë të kërkojë sa më sipër, materialet më voluminoze janë dërguar që në datën 30 korrik 2020, përveç një shkrese në rastin konkret që mund të mos e kenë pasur. I kërkohen nëse është në gjendje për të dhënë opinionin në lidhje me procedurën për këtë rast.

Enio Haxhimihali shprehet se kjo vlen vetëm për kandidatin Eugen Papandile.

Vitore Tusha kërkon mendimin e anëtarëve në lidhje me këtë qëndrim të përfaqësuesit të Avokatit të Popullit, i cili është vëzhgues dhe monitoron Këshillin në lidhje me procedurën e ndjekur, duke ngritur si çështje nëse mosdhënia e një opinioni prej tij sjell ndikim në vijimin e procedurës.

Anëtarët, pas diskutimeve të çështjes së ngritur nga përfaqësuesi i Avokatit Popullit, ranë dakord të vijojnë me rendin e ditës sikurse u miratua.

Vitore Tusha fton anëtarët të vijojnë me miratimin e procesverbalit të mbledhjes së datës 16.09.2020.

Anëtarët miratojnë procesverbalin e mbledhjes së datës 16.09.2020.

Vitore Tusha fton anëtarët të vijojnë me çështjen e rendit të ditës që lidhet me informacionin për funksionimin efikas dhe efektiv të KED-së, material që iu është bërë prezent ditën e premte anëtarëve, anëtarëve zëvendësues dhe të ftuarve në mbledhje. Vazhdon me prezantimin e materialit.

Funksionimi i Gjykatës Kushtetuese është një çështje me rëndësi për zhvillimin e demokracisë në Shqipëri dhe për procesin e integritet në Bashkimin Evropian. Në këtë proces, e së njëjtës rëndësi është edhe përmbushja e funksioneve dhe ushtrimi i veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin, me qëllim rivënien në funksion të Gjykatës Kushtetuese si një çështje imperative për vendin tonë. Gjatë vitit 2020 KED-ja ka kryer procedurat e verifikimit për 3 vakanca të shpallura në Gjykatën Kushtetuese (2 nga Presidenti dhe 1 nga Kuvendi). Në lidhje me vakancën e parakohshme të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, pas përfundimit para kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj dhe të rishpallur në datën 27.09.2019, si dhe vakancën e parakohshme të shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018, pas përfundimit para kohe të mandatit të gjyqtarit Fatos Lulo, dhe të rishpallur në datat 21.08.2019, procedura ka qenë e përfunduar që në fillim të muajit mars 2020. Megjithatë, ka pasur disa faktorë që kanë ndikuar në marrjen e vendimeve në lidhje me kandidatët për këto vakanca në datën 17 korrik 2020 dhe 17 gusht 2020, të cilat janë:

-procedurat ligjore dhe afatet që duhen ndjekur për të siguruar një hetim të thelluar të kandidatëve, jo vetëm përfshijnë në këtë proces shumë institucione, agjenci ligjzbatuese, subjekte publike dhe private, por kërkojnë një kohë relativisht të gjatë për administrimin, përpunimin dhe vlerësimin e të dhënave;

-përfundimi i mandatit të KED-së 2019, pa përfunduar verifikimi i kandidaturave për 3 vakancat dhe konstituimi i KED-së 2020, e cila me fillimin e veprimtarisë së saj kreu procedurat e shortit për relatorët e rinj, të cilët në përmbushje të përcaktimeve ligjore verifikuan dhe pranuan veprimet e kryera më parë;

-forma e organizimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (*ad hoc*) është një sfidë për të gjithë anëtarët e tij dhe kryesisht për anëtarët relatorë, të cilët pavarësisht detyrës që duhet të ushtrorjnë në KED, ushtrorjnë detyrën funksionale në institucionet përkatëse me ngarkesë të plotë, çka kërkon përgjegjësi të shtuar për përmbushjen e funksionit;

-numri i reduktuar i personelit administrativ të Gjykatës së Lartë (këshilltarë dhe sekretarë) dhe ngarkesa e madhe në detyrat funksionale që ky personel është i ngarkuar të përballojë, si për shkak të volumit të punës së Gjykatës së Lartë, ashtu edhe detyrave që i janë ngarkuar me ligj për të ndihmuar anëtarët e KED-së në përmbushjen e funksionit;

-situata e imponuar nga gjendja e krijuar nga përhapja e virusit Covid 2019, që solli pezullimin e veprimtarisë së institucioneve. Në këtë periudhë u konsiderua mundësia e komunikimit elektronik apo e zhvillimit të mbledhjeve *online*, por u vlerësua se kjo nuk garantonte kërkesën ligjore që mbledhjet të mbahen të mbyllura, në kuptim të nenit 233 të ligjit nr. 115/2016;

-situata ligjore në lidhje me mandatin e anëtarit të Gjykatës së Lartë, që ushtronte funksionin e Kryetarit të KED-së, i cili vetëm në datën 23 qershor 2020 njoftoi Këshillin për pamundësinë e vijimit të ushtrimit të kësaj detyre;

-procesi i hartimit dhe miratimit të ndryshimeve në aktet e KED-së, në frymën dhe sipas rekomandimeve të Komisionit të Venecias, të cilat duheshin respektuar në procedurat që ndiqen gjatë shqyrtimit të gjetjeve për kandidatët;

-pas ndryshimit të akteve nënligjore, si më lart, në verifikimin e kandidatit magjistrat duhej të pritej vendimi përfundimtar i organeve të rivlerësimit kalimtar, arsye për të cilën shqyrtimi i një kandidati u bë në datën 17.08.2020, pas komunikimit të vendimit të KPA-së në datën 04.08.2020 edhe pse KED-ja, që prej muajit janar të vitit 2020 i ka kërkuar KPA-së zyrtarisht përsheptimin e procedurës së këtij kandidati.

Në lidhje me vakancën e parakohshme të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 22.11.2019, pas përfundimit të mandatit para kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Muçi, konstatohen, përveç disa nga faktorët e mësipërm, edhe sa vijon:

-vonesa në procedurën e pajisjes së anëtarëve të KED-së 2020, përfshirë edhe relatoren, me certifikata sigurie (për ata anëtarë që nuk kishin qenë pjesë e KED-së së mëparshme), ku përfshihet edhe dërgimi nga ana e KED-së të shkresave përkatëse drejtuar DSIK-së;

-mospajisja me certifikatë sigurie e relatores ka sjellë vonesa edhe në njohjen, shqyrtimin dhe verifikimin e një kategorie të informacionit (i klasifikuar) dhe komunikimin e mëtejshëm me disa nga institucionet e përfshira në proces për plotësimin e informacionit, siç janë shkresat e dërguara nga SHÇKB-ja apo DSIK-ja;

-me njoftimin e datës 13.07.2020, Gjykata e Lartë njoftoi reduktimin e veprimtarisë së saj për një kohë të pacaktuar, për shkak se një punonjës i kësaj gjykate rezultoi pozitiv me Covid 19. Sipas ligjit Këshilli ka selinë e tij në këtë gjykatë dhe administrata e Gjykatës së Lartë e ndihmon Këshillin në punën e tij. Kjo situatë e reduktimit të veprimtarisë zgjati për muajt korrik-gusht 2020, ku përfshihet edhe periudha e lejes vjetore;

-në mbledhjen e datës 17 korrik 2020, Avokati i Popullit propozoi që KED-ja të zgjeronte spektrin e hetimit për kandidatët në lidhje me kriterin e mospërfshirjes në veprimtari politike, duke i kërkuar informacion edhe KQZ-së, si subjekt që mund të ndihmonte për adresat e subjekteve politike që deri në atë kohë nuk ishin përfshirë në subjektet që u ishte kërkuar informacion. Për rrjedhojë, pas rekomandimeve të Avokatit të Popullit, si përpjekje maksimale për të verifikuar në lidhje me kriterin politik, KED-ja i dërgoi shkresat përkatëse KQZ-së dhe pas ardhjes menjëherë të informacionit nga ky

institucion për rreth 53 parti, gjatë muajit gusht atyre iu dërguan shkresat përkatëse ku u kërkohej informacioni në lidhje me secilin kandidat.

Sa më sipër, kanë ndikuar në përgatitjen e relacioneve nga relatori dhe, për rrjedhojë, edhe në caktimin e mbledhjes së Këshillit. Pas pajisjes në datën 10 shtator 2020 me certifikata sigurie të anëtarëve të KED-së, ka vijuar me përparësi puna për përmbylljen e relacioneve dhe caktimin menjëherë të mbledhjes së datës 16 shtator 2020. Ndërkohë, arsyetimi i të gjitha vendimeve të marra nga KED-ja është përfunduar brenda një afati të arsyeshëm 5 deri në 10 ditë. Nuk ka pasur vonesa në zbardhjen e vendimeve apo komunikimin e tyre kandidatëve.

Konkretisht, vendimet e KED-së të datës 17.07.2020 për kandidatët Envi Hicka, Prel Martini, Klodian Rado dhe Besnik Muçi janë zbardhur në datën 22.07.2020. Vendimet për kandidaten Vjosa Bodo janë zbardhur në datat 27.07.2020 dhe 28.07.2020. Vendimi për kandidaten Ardita Buna (Alsula) është zbardhur në datën 27.07.2020, kurse vendimet për kandidatët Dedë Kasneci, Shaqir Hasanaj dhe Vasil Bendo janë zbardhur në datën 28.07.2020.

Vendimi i KED-së i datës 17.08.2020 për kandidaten Regleta Panajoti është zbardhur në datën 27.08.2020.

Vendimi i KED-së i datës 21.08.2020 për kandidatin Shaqir Hasanaj, i marrë pas vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, është zbardhur në datën 28.08.2020.

Vendimet e KED-së të datës 16.09.2020 për kandidatët Altin Binaj, Artan Spahiu, Dedë Kasneci dhe Gentian Mete janë zbardhur në datën 25.09.2020.

Menjëherë pas zbardhjes së tyre, këto vendime u janë komunikuar kandidatëve, në rrugë elektronike dhe me postë, si dhe janë publikuar në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë për KED-në.

Problematikat si më sipër do të jenë pjesë e raportit vjetor të veprimtarisë së KED-së, por ndërkohë disa prej tyre janë trajtuar edhe në mbledhjet e Këshillit. Në këto mbledhje, duke qenë se janë të pranishëm, përveç Avokatit të Popullit, edhe përfaqësuesit e Presidentit të Republikës, të Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, si dhe të komisionit të përhershëm përgjegjës për çështjet ligjore në Kuvend, ata kanë të drejtë të njihen edhe me veprimtarinë e Këshillit, si dhe të parashtrojnë të gjitha argumentet apo problematikat në lidhje me çështjet e shqyrtuara prej tij. Në këtë kuptim, këta përfaqësues kanë pasur informacionin e duhur dhe të mjaftueshëm në lidhje me ecurinë e procedurave të ndjekura nga KED-ja, si dhe kanë pasur mundësinë për të kërkuar çdo informacion shtesë në lidhje me çështjet që vlerësojnë me rëndësi.

Këshilli, duke kryer një punë voluminoze, ka vijuar me seriozitet dhe intensitet veprimtarinë për verifikimin dhe shqyrtimin e kandidaturave, në drejtim të përfundimit me shpejtësi të procesit të verifikimit të kandidatëve. Në këtë proces KED-ja ka ushtruar veprimtarinë në përmbushje vetëm të dispozitave kushtetuese dhe ligjore, si dhe të akteve normative të miratuara prej saj.

Procedura e ndjekur deri më tani nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi ka qenë në fokusin e vëzhgimit publik, atij të organeve të emërtesës si edhe të faktorëve të tjerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, ndaj vlerësova të pasqyroj kuadrin ligjor që rregullon veprimtarinë e këtij organi.

Procedura për verifikimin e kushteve ligjore, që nga momenti i dërgimit të listave të kandidatëve nga organet e emërtesës dhe deri në përfundimin e shqyrtimit gjyqësor në lidhje me vendimmarrjen e

KED-së për ndalimet e kandidatëve, është rregulluar nga Kreu IV i Pjesës V (nenet 234 -238) të ligjit nr. 115/2016.

Këto dispozita e kanë rregulluar procedurën për verifikimin e pasurisë, verifikimin e integritetit dhe të kushteve të tjera ligjore në mënyrë të veçuar, duke parashikuar afate të ndryshme në secilin rast. Referuar nenit 235, në lidhje me kontrollin e pasurisë, ai ka parashikuar një afat 15-ditor për dorëzimin e formularëve pranë ILDKPKI-së nga dita e marrjes së tyre nga kandidatët, dhe një afat 30-ditor për përfundimin e procesit të kontrollit nga ana e ILDKPKI-së.

Neni 236, në lidhje me kontrollin e integritetit, ka parashikuar një afat 5-ditor për dorëzimin e formularëve nga marrja e tyre nga kandidatët dhe një afat 30-ditor për Prokurorinë e Përgjithshme për kryerjen e verifikimit, ndërkohë që nuk ka parashikuar ndonjë afat për organet e tjera ligjzbatuese nga të cilat Këshilli kërkon informacion në lidhje me kandidatin.

Në lidhje me kushtet e tjera ligjore që duhet të plotësojë kandidati, neni 237 ka parashikuar një afat 35-ditor nga momenti i ardhjes së listave të kandidatëve për verifikimin e tyre nga KED-ja.

Siç rezulton qartësisht nga dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e KED-së në lidhje me shqyrtimin e kandidatëve, ky proces është i ndarë në dy faza: faza e parë e shqyrtimit për plotësimin e kushteve dhe kriterëve ligjore, që përmbyllet me vendimmarrjen në lidhje me ndalimin/lejimin e kandidimit (Kreu IV); faza e dytë, e cila nis pas përfundimit edhe të shqyrtimit gjyqësor të vendimeve të KED-së të fazës së parë sipas nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, dhe rregullohet nga Kreu V, që parashikon procedurën për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve (nenet 239-240 të ligjit nr. 115/2016).

Mbi këtë bazë ligjore janë miratuar edhe aktet normative nga KED-ja. Për verifikimin e kushteve ligjore është miratuar vendimi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar, kurse për vlerësimin dhe renditjen e kandidatëve është miratuar vendimi nr. 5, datë 02.04.2019 “Për kriteret dhe procedurën e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, i ndryshuar.

Për sa më sipër, asnjë dispozitë ligjore apo nënligjore nuk e pengon shqyrtimin në mënyrë të shkëputur, të copëzuar apo të fragmentarizuar të gjetjeve në procedurën e verifikimit të kandidatëve. Po ashtu, edhe në praktikën e pakontestuar të ndjekur nga vetë KED-ja gjatë vitit 2019 dhe deri në muajin korrik 2020, është proceduar me shqyrtimin në grup të çështjeve duke i ndarë dhe grupuar ato sipas problematikave të njëjta apo kohës së përgatitjes dhe përcjelljes së relacioneve nga relatori.

Bazuar në përmbajtjen e nenit 235 (për kontrollin e pasurisë), nenit 236 (për kontrollin e kandidatëve) dhe nenit 237 (për verifikimin e kushteve të tjera ligjore) të ligjit nr. 115/2016, duke qenë një proces kompleks ku përfshihen shumë institucione dhe ku informacioni mbi të cilin bazohet KED-ja duhet të përcillet nga institucione të tjera me të cilat ajo bashkëpunon, verifikimi i të gjitha kriterëve dhe kushteve ligjore dhe përfundimi i procedurës së verifikimit nga ana e KED-së, nuk mund të bëhet pa përfunduar kontrollin e tyre organet e tjera të përfshira në këtë proces.

Po ashtu, dispozitat ligjore të sipërcituara kanë rregulluar në mënyrë të veçuar verifikimin dhe procedurën për secilin kriter vlerësimi, pra pasuria, integriteti dhe kushtet e tjera. Mjafton edhe vetëm mosplotësimi i njërit kriter që KED-ja të përfundojë procedurën e verifikimit të një kandidati të caktuar.

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave, qartësisht rezulton se shqyrtimi i secilës kandidaturë në fazën e lejimit/ndalimit të kandidimit është një proces që kryhet nga Këshilli bazuar në vlerësimin individual të gjetjeve dhe vendimmarrjes në lidhje me secilin kandidat.

Asnjë dispozitë ligjore nga ato të lartpërmendura nuk vendos detyrimin për KED-në që të shqyrtojë në mënyrë të njëkohshme të gjitha kandidaturat për një vakancë në fazën e parë. Rregullimi ligjor është i ndryshëm në fazën e dytë, në të cilën kryhet vlerësimi dhe renditja e kandidatëve të lejuar për kandidim. KED-ja, në referim të nenit 239 të ligjit nr. 115/2016, duhet të thërrasë brenda një afati 5-ditor mbledhjen, në të cilën do të kryhet vlerësimi dhe renditja e kandidatëve që janë lejuar për të vazhduar konkurrimin dhe Këshilli qëndron i mbledhur deri në përfundimin e procesit të vlerësimit dhe renditjes së kandidatëve, proces që duhet të përmbillet jo më vonë se 10 ditë nga dita e mbledhjes.

Ndarja e disa kandidaturave për shqyrtim në mbledhjen e datës 16.09.2020 është bërë mbi bazën e kohës së përfundimit të procesit të verifikimit dhe dërgimit të relacioneve të përfunduara nga ana e relatores. Në momentin që relacionet i janë përcjellë zv/Kryetares nga relatori, është thirrur menjëherë mbledhja e radhës e KED-së për shqyrtimin e gjetjeve në procedurën e verifikimit për kandidatët në garë dhe vendimmarrja lidhur me lejimin/ndalimin e kandidimit të këtyre kandidatëve.

Këshilli, në respektim të procedurave dhe afateve ligjore të lartpërmendura, me shumë vullnet, ka vijuar dhe do të vazhdojë punën për përfundimin e vlerësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidaturave të tjera në garë, si dhe renditjen e tyre, me qëllim të përmbushjes së funksionit thelbësor të tij në procesin e ngritjes së Gjykatës Kushtetuese.

Në përfundim të prezantimit u kërkuan mendime në lidhje me masat që duhen marrë në drejtim të rritjes së efikasitetit të veprimtarisë së këtij Këshilli.

Fiona Papajorgji shprehet se për sa i përket pasqyrimit të informacionit të prezantuar nuk sheh ndonjë masë që mund të merret paraprakisht për të përfunduar procedurën për shqyrtimin e kandidaturave të vakancës në shqyrtim. Për të ardhmen kjo do të kërkojë një studim më të thellë, që mund të shoqërohet edhe me ndryshime ligjore.

Arta Marku shprehet se është dakord me opinionin e znj. Papajorgji dhe se nuk mendon se ka diçka që nuk është bërë nga ana e Këshillit.

Miranda Andoni është dakord me informacionin e prezantuar dhe vlerëson se janë pasqyruar midis të tjerave qartë edhe faktorët që kanë ndikuar në vendimmarrjen e Këshillit. Duke marrë shkas që në relativitetin që i është ngarkuar asaj shkak për vonesën ka qenë pajisja me certifikatën e sigurisë, shprehet se ndoshta do të duhet një zgjidhje në lidhje me këtë, në rastet kur anëtarët duhet të pajisen me certifikatë sigurie ose ndoshta kjo duhet të gjejë një zgjidhje tjetër.

Saida Dollani shprehet se nuk ka asnjë koment.

Ludovik Dodaj është dakord me problematikat e nxjerra për punën e KED-së deri në këtë fazë. Shprehet se në material dalin probleme që shkaktojnë vështirësi në funksionimin e KED-së dhe në të ardhmen, në bashkëpunim dhe në lidhje me institucionet që përfaqësojnë në këtë mbledhje, duhet të jenë më fleksibël dhe më të shpejtë për të nxjerrë në pah sa më shpejt të gjitha mundësitë dhe kushtet ligjore për t'u përgjigjur në të ardhmen.

Fatjona Memçaj shprehet se informacioni është i hollësishëm dhe se është parashtruar e gjithë puna e KED-së dhe vështirësitë që Këshilli ka pasur.

Marsida Xhaferllari shprehet se vlerëson punën për paraqitjen e informacionit, duke e ditur edhe vështirësinë e drejtimit të Këshillit nga zv/Kryetarja në këto momente dhe mbështetjen e saj nga një administratë që është larg zyrës së saj. Evidenton se sot çdokush vë në dukje brenda vendit dhe jashtë nevojën jetike që ka vendi për Gjykatën Kushtetuese dhe thirrjen që po i bëhet të gjitha institucioneve, që janë pjesë e këtij procesi të shpejtojnë që vendi të mos rrijë pa Gjykatë Kushtetuese. Shprehet se gjithsecilit i bie barra të veprojë sa më shpejt dhe në përputhje me ligjin.

Konstaton se materiali i paraqitur tregon për një grup problemesh, që mund të adresohen nëpërmjet ndryshimeve ligjore. Hartimi i raportit vjetor mund të jetë një moment shumë i mirë ku Këshilli duhet të reflektojë dhe të japë propozime serioze, meqë Këshilli është një organ i krijuar nga elita e profesionistëve të së drejtës, me qëllim identifikimin e të gjitha problemeve për të përshpejtuar procesin në situata të tjera të ngjashme. Pranon se vonesa ka pasur edhe faktorë të tjerë që nuk lidhen me zbatimin e ligjit, siç janë faktorët individualë, ku një prej tyre u përmend edhe nga znj. Andoni, që lidhet me vonesën e tepruar të Kryetarit të KED-së për pajisjen e anëtarëve të KED-së me certifikata sigurie. Sugjeron që në situatat ku konstatohen veprime individuale që kanë shkaktuar vonesat, duhen marrë masa konkrete. Në kohën e hartimit të raportit, duhet të dalin rekomandimet për ndryshimet ligjore apo për masa ekzekutive.

Përsërit shqetësimin për përfshirjen e DSIK-së në proces, që jo vetëm intimidon kandidaturat, por edhe shpenzon kohë të panevojshme në drejtim të pajisjes së anëtarëve me certifikata sigurie, në paraqitjen e kërkesave për informacion, në mbledhjen e informacionit nga DSIK prej agjencive të tjera ligjzbatuese, në paraqitjen e informacionit pranë KED-së të klasifikuar “sekret shtetëror”, në kërkesën e Këshillit për deklasifikimin e informacionit, në mbledhjen e Komisionit të posaçëm të DSIK-së për deklasifikimin e informacionit deri në paraqitjen e informacionit të deklasifikuar pranë KED-së. E gjithë kjo kohë shpenzohet për të administruar në përfundim një informacion të deklasifikuar, që sipas ligjit duhet t'i vihet në dispozicion kandidatit dhe do të përdoret për verifikimin e kandidimit. Këto momente duhen analizuar, ndoshta në kohën e hartimit të raportit.

Për sa i takon verifikimit individual të kandidatëve, pajtohet që çdo proces verifikimi ka individualitetin e vet, po sot ky problem nuk ekziston, sepse KED-ja në mbledhjen e sotme ka përfshirë të gjithë kandidatët e mbetur dhe mbyllet ky proces. Shprehet se sot nuk ka vend për të riparuar gjë për vakancat që janë në proces. Thekson në parantezë se nisur nga përvoja e saj, një kandidat që kandidon në mes të 17 kandidatëve kur i vjen njoftimi që KED-ja ka përfshirë në rendin e ditës 5 kandidatë dhe vetë ai është përfshirë në mbledhjen e radhës, fillon e shqetësohet. Po ashtu, edhe të tretët që e vëzhgojnë fillojnë dhe ngrenë hipoteza se çfarë po ndodh me kandidatin që është veçuar. Me qëllim që të sigurohet që këto procese individuale të shqyrtohen me shpejtësi, pa krijuar dyshime të panevojshme për punën që bëhet brenda Këshillit, sugjeron që në të ardhmen procesi të rakordohet, në kuptimin e dërgimit të shkresave njëkohësisht në institucionet dhe kërkimi prej tyre i përgjigjeve në grup. Në momentin që vijnë përgjigjet në të njëjtën kohë për të gjithë kandidatët, edhe Këshilli do të jetë në gjendje t'i shqyrtojë pa pasur distancime kohore.

Bilbil Mete është dakord me informacionin, i cili është i argumentuar. Në vijim shprehet se që të mund t'i jepet zgjidhje problemit mendon që KED-ja duhet të dijë konkretisht cilët janë ata që pengojnë, cilat zyra institucionesh janë, cilët persona janë, nëse ka shkaqe objektive apo ka qëndrime subjektive që

mund ta mbajnë peng KED-në deri në pafundësi. Në rast se i drejtohet DSIK-së një shkresë dhe ajo thotë e kam përcjellë në një institucion tjetër, cili është ky institucion tjetër, sa kohë ka që nuk përgjigjet, pse nuk i përgjigjet? Shprehet që nëse është e mundur, KED-ja duhet të caktojë 1 ose 2 persona që të marrin kontakt të përditshëm me personat që janë përgjegjës për të kthyer përgjigje, qoftë me shkresa, qoftë me telefona. Shprehet se veprimtaria e KED-së nuk mund të pengohet për 1 vit dhe se mund të ketë edhe persona që duan ta pengojnë këtë veprimtari qëllimisht.

Nazmi Troka është dakord me materialin dhe shprehet se janë probleme që kanë dalë gjatë punës konkrete që kërkojnë zgjidhje dhe ndryshime nënligjore, duke u bërë dhe propozimi në institucionet përkatëse.

Enio Haxhimihali shprehet se, sikurse kemi theksuar vazhdimisht, institucioni i Avokatit të Popullit është përpjekur të mbështesë punën e KED-së dhe kjo jo vetëm duke u shprehur në takimet me aktorë të ndryshëm, apo raportet e hartuara për këtë qëllim, por edhe duke bërë sa më mirë punën tonë. Në mars të këtij viti institucioni i Avokatit të Popullit ka hartuar një raport të veçantë për veprimtarinë e KED-së gjatë vitit 2019, i cili për shkak të pandemisë u depozitua pak më vonë, që njëkohësisht i është dërguar dhe KED-së 2020. Në këtë raport, në rast se do të ishte shqyrtuar, bëhet fjalë për çështje që do të rrisnin efikasitetin dhe efektivitetin e këtij organi. Edhe në raportin vjetor 2019 të KED-së kishte propozime konkrete për mënyrën se si mund të bëhej më efikase dhe më efektive puna e KED-së, të cilat duhet të ishin përkthyer në veprime konkrete. Pra duhet të ishte hartuar një planveprimi konkret për rekomandimet e bëra, për detyrat e lëna në këtë raport të vitit 2019. Mund të themi se KED ka “një të metë”, pasi është një organ që vit për vit ndërrohet, pra KED-ja e vitit 2020 duhet të marrë në shqyrtim çfarë ka thënë KED-ja paraardhëse dhe nëse i miraton apo bie dakord me rekomandimet e KED-së të mëparshme, duhet t’i kthejë në planveprimi. Avokati i Popullit do të vazhdojë të mbështesë KED-në dhe gjithashtu besojnë se duke bërë mirë punën, i shërbejnë rritjes së efikasitetit dhe efektivitetit të këtij organi.

Mimoza Arbi falënderon zv/Kryetaren për informacionin e përmbledhur në lidhje me veprimtarinë e KED-së gjatë vitit 2020. Shprehet se pavarësisht problematikave të parashtruara, krahas faktorëve objektivë të problemeve të kuadrit ligjor, përfshihen edhe faktorë subjektivë. Ndoshta për faktin e situatës së Covid-19, që vazhdojmë të kalojmë, por edhe shumë faktorëve të tjerë, nga këqyrja e materialeve të vëna në dispozicion, rezulton se komunikimi i KED-së me institucionet nga të cilat ajo merr informacion nuk ka qenë në nivelin e duhur. KED-ja është mjaftuar vetëm me dërgimin e shkresës për kërkimin e informacionit, por nuk është rritur fryma e bashkëpunimit me këto institucione për marrjen e informacionit. Prandaj ky institucion ka mbështetur shqetësimin e ngritur nga Presidenti i Republikës në mbledhjen e KED-së. Përveç faktorëve objektivë, se faktorët ligjorë në analizën vjetore mund të nxirren nga KED-ja si problematika, të para këto edhe nga Kuvendi si organ ligjibërës për përmirësimin e këtij kuadri ligjor, janë dhe faktorët subjektivë, mungesa e bashkëpunimit me këto institucione. Në vlerësimin e saj nuk mendon se institucionet do të kenë qëllime për zvarritjen e procesit, ashtu si dhe anëtarët e KED-së janë lodhur, pasi krahas punës konkrete që kanë në gjyqësor, kanë ardhur për të kryer edhe një detyrë të cilën shorti ua ka caktuar si anëtarë të KED-së. Por janë dhe faktorët subjektivë, vonesa ka pasur qoftë me kërkesën për pajisjen me DSIK, vonesa drejtuar institucioneve për marrjen e informacionit, moskomunikimi me drejtuesit e këtyre institucioneve për ardhjen e

informacionit. Nga ana tjetër është e vërtetë që edhe organet e emërtesës kërkojnë informacion se ku qëndron problemi për zvarritjen, sepse nuk mund të ketë asnjë lloj justifikimi qoftë ligjor, qoftë subjektiv, zvarritja 1 vit për të shqyrtuar një vakancë. Kjo e sjell dhe e bën “non sens” të gjithë kuadrin ligjor për të cilën janë bërë ndryshime qoftë në Kushtetutë, qoftë në kuadrin ligjor për Gjykatën Kushtetuese apo për organizimin dhe funksionimin e organeve të sistemit të drejtësisë për plotësimin e vakancave. Duke vlerësuar natyrisht problemet dhe shqetësimet e ngritura nga zv/Kryetarja, shprehet se KED-së i mbetet detyrë rritja e bashkëpunimit me këto institucione.

Vitore Tusha shprehet se KED-ja, të paktën në këtë periudhë, ka komunikuar me institucionet dhe se nuk ka pasur asnjë komunikim tej mjeteve të parashikuara me ligj. Çdo raportim që ka qenë i detyrueshëm në përputhje me ligjin është bërë dhe është përcjellë në mënyrë të hollësishme. Në material janë përmendur të gjithë faktorët dhe jo pa qëllim nuk janë cilësuar si objektivë dhe subjektivë dhe gjithsecili e vlerëson sa këta faktorë ndikojnë në funksionimit brenda KED-së. I vetmi vlerësim i bërë në material janë vlerësimet e natyrës ligjore dhe vlerësimi se KED-ja ka pasur dhe ka vullnet maksimal për të ecur brenda mundësive ligjore sa më shpejt të jetë e mundur.

Bledar Dervishaj shprehet se informacioni, materiali informues i dërguar, në vetvete nuk është një informacion i plotë, as dhe i saktë në disa momente, për të arritur në një konkluzion mbi funksionin “efikas dhe efektiv” të KED-së! Që të arrihej në këtë konkluzion duhej që më parë të kryhej një hetim/vlerësim më i plotë mbi ecurinë e procesit të shqyrtimit të këtyre 3 vakancave. KED-ja 2020 nuk i erdhën aplikimet rishtazi në janar për këto vende vakante. KED trashëgoi nga KED 2019, 3 vende vakante në proces shqyrtimi, 3 palë lista që i përkasin për plotësim dy organeve të emërtesës (President dhe Kuvend). Lidhur me këtë situatë dhe informacionit të paraqitur do të shtroja pyetjen: Këtë informacion e ka hartuar vetëm zv/Kryetarja apo bashkë me relatorët e të 3 vakancave? Këtë pyetje e ngre sepse ky informacion i përgatitur, nëse i përgjigjet letrës së Presidentit kërkon një hetim pak më të thellë mendojmë ne. Kjo sepse ne si institucion kemi bërë një krahasim të të dhënave të siguruara po nga KED-ja, jo nga ndonjë institucion tjetër dhe na rezulton se ky informacion i prezantuar sot, është jo i plotë. Disa fakteve e të dhënave që vërtetë tregojnë subjektivizëm në këtë proces, nuk u është dhënë përgjegjësia. Ne si institucion e kemi bërë analizën tonë. Po marr vakancën e Presidentit të Republikës, atë që është rishpallur tashmë për aplikim: ish-gjyqtari Besnik Imeraj jep dorëheqjen në datën 31 janar 2018. Kjo vakancë u shpall për aplikim nga Presidenti në datën 7 shkurt 2018. U pezullua procedura e shqyrtimit nga KED-ja në 21 shtator 2019 për shkak se në garë ngelën vetëm dy kandidatë të kualifikuar zj.Regleta Panajoti dhe z. Besnik Muçi. U rishpall menjëherë nga Presidenti; U përcollën sërish listat në KED; në datën 22 tetor 2019 filloi procedura e verifikimit. Relatorët ishin të caktuar. Mbeteshin për t’u verifikuar 6 kandidatët që aplikuan rishtazi. Nga ky moment, po marr dhjetor 2019, pse shkuam ne në datë 17.08.2020 ? Dhe për t’i dhënë përgjigje kësaj pyetje me duhet të citoj disa fakte për të nxjerrë “efektivitetin dhe efikasitetin” e KED, apo të kundërtën e këtyre, si të KED 2019 apo dhe KED 2020. Duhet t’i themi gjerat siç janë, nëse do të duhet ta zgjidhim. Nëse jo, i kalojmë përciptazi, që është bërë si informacion dhe kaq. Por gjendja duhet prezantuar siç është. Atëherë, për të dalë në këtë konkluzion pyetja që bëhet sërish është: Kur është mbyllur hetimi administrativ për secilin nga kandidatët, pra për ata 6 kandidatë që erdhën rishtazi? Po flas për vitin 2019. Janë pyetje që duhet të marrin përgjigje. Pra në çfarë date rezulton informacioni i fundit i siguar nga KED? Kur ka ndodhur?, apo kur relatori ka njoftuar Kryetarin e KED-së, që këto vakanca janë gati për shqyrtim, që ky kandidat është i gatshëm për shqyrtim? Ju mbrojtët tezën që kandidatët shqyrtohen veçmas, shumë dakord.

Përse relatori nuk ka përfunduar menjëherë vlerësimin për secilin kandidat? Se nga dokumentacioni rezulton se ka pasur kandidatë që kanë hequr dorë nga kandidimi që vitin e kaluar (2019) dhe vijnë të qëndrojnë në lista si kandidatë, pa ndonjë arsye deri në korrik 2020. Ndërkohë që rregullorja përcakton se, sa heq dorë kandidati, menjëherë thotë rregullorja, relatori përgatit raportin dhe e dërgon në Këshill. Pra p.sh., sa u shkarkua z.Besnik Muçi nga KPA, relatori përgatit raportin dhe shkon në Këshill. Përgjigjet e këtyre pyetjeve do të nxirrin në dritë se ku ka ngelur procesi, sepse për këtë vakancë të parakohshme, në momentin e shpalljes për herë të parë për aplikim (shkurt 2018) kjo vakancë kishte 4 vjet e 3 muaj mandat të mbetur, tani ka më pak se 2 vjet. Në rastin e kësaj vakance, nuk shikoj problematike dhënien e informacionit nga institucionet e treta, sepse hetimi administrativ për shumicën e kandidatëve, për 4 prej tyre, është mbyllur në 4 dhjetor 2019. Këtë nuk e themi ne, këtë e thotë dhe vetë Këshilli në raport. Këshilli ka arkiv, ka historik, jo vetëm të anëtarëve që një pjesë janë edhe sot, edhe të dokumentacionit, por dhe të personave që marrin pjesë si të ftuar. E thotë vet Këshilli në raportin vjetor të veprimtarisë për vitin 2019, që nga 6 kandidatë janë gati për shqyrtim 4 kandidatë, ngelen 2 (dy) prej tyre. Këtë që thotë Këshilli në 30 dhjetor 2019 dhe që është miratuar në raportin vjetor me shumë polemika në atë mbledhje dhe ne kemi qenë këtu, ne si institucion e kemi krahasuar dhe me relacionet e përgatitura nga relatorët për secilin kandidat që na u njoftuan në 17 korrik 2020 dhe na rezultoi e vërtetë. Po, vetëm 2 kandidatë kanë mbetur për t'u komunikuar në janar 2020 dhe në shkurt data e fundit 21, mos gaboj, relatorja është këtu znj.Marku mund të na i saktësoj. Po marr prapë shembullin e kandidatit Besnik Muçi që kandidonte edhe tek kjo vakancë e parakohshme. Zoti Muci u emërua në datë 15 tetor 2019 për plotësimin e një tjetër vendi vakant (të ish-gjyqtarit Sokol Berberi). Në këtë mënyrë në këtë moment zoti Muci e humbi statusin për të qenë kandidat edhe tek kjo vakanca tjetër (të ish-gjyqtarit Bensik Imeraj). Kjo çështje duhej të kalonte urgjent në Këshill, të merrej vendim për përfundimin e procesit. Pasi kanë kaluar 8 muaj, futet në mbledhjen e këshillit shqyrtimi i kësaj kandidature në 17 Korrik 2020 dhe kjo vetëm me ardhjen e znj.Tusha, si zv/Kryetare, pas marrjes së detyrës prej saj, filluan të lëviznin gjërat. Tjetër kandidat është z.Prelë Martini, ka dhënë dorëheqjen nga kandidimi që në 8 nëntor 2019. Rregullorja thotë që menjëherë pas paraqitjes së dorëheqjes relatori përgatit raportin, ja dërgon Kryetarit dhe Kryetari thërret mbledhjen. Kjo nuk është bërë. Ikën dy kandidatë. Z. Dedë Kasneci, po flas gjithmonë sipas relacioneve, të më ndjeni, në 03.12.2019 ka mbaruar procesi i mbledhjes së informacionit për të. Ndërkohë që pas 8 muaj futet në procedurë shqyrtimi në KED. Për z. Shaqir Hasanaj ka një komunikim të fundit me kandidatin të datës 17 Shkurt 2020 ku i është kërkuar sqarim dhe ai më pas ka dhënë komentet e tij. Atëherë pse edhe ky kandidat nuk u fut për shqyrtim në atë kohë? Pse këta të tjerët nuk u futen radhë pas radhë në shqyrtim në Këshill, siç ju e interpretoni ligjin, e që mund të shqyrtohen dhe në bllok? Disa prej tyre kanë dhënë dorëheqjen nga kandidimi dhe kanë humbur statusin e kandidatit, ndërkohë që për disa të tjerë mbledhja e informacionit ka mbaruar prej kohësh! Këshilli 2020 në vetvete në fillimet e tij me propozim të znj.Marsida Xhaferllari ka zhvilluar 3 mbledhje, qofsha i gabuar, për ndryshimin e akteve nënligjore. Me të drejtë znj.Xhaferllari ngriti propozim dhe ishin po ato propozime që Venecia i tha “po, kështu duhet!”. Por mos të harrojmë që një nga vakancat e Presidentit kandidatët e së cilës ju do të shqyrtoni sot sipas pikës së dytë të rendit të ditës është shkaktuar për shkak të pakujdesisë të Këshillit. Sepse është kërkuar nga Presidenti i Republikës dhe nga Avokati i Popullit, nuk e di nga përfaqësues të EURALIUS se nuk e mbaj mend këtë diskutim: “Nuk duam kandidatë pa vendim të formës së prerë! Ju lutem rregulloni aktin nënligjor!” – Jo, tha Këshilli, do vazhdojmë se humbasim kohë! Ja ku erdhëm, kandidati i zgjedhur, u

shkarkua nga KPK pa vendim të formës së prerë dhe sot po shqyrtojmë për plotësimin e së njëjtës vakancë, por tashmë kanë kaluar edhe 11 muaj të tjerë. Po kjo, nuk është një vonesë e Këshillit? Këshilli a e mori dhe një herë në janar çështjen e akteve nënligjore dhe që trajtojnë këtë gjë (vettingun me formë të prerë) dhe ja rrëzoi propozimet znj.Xhaferllari? U desh të vinte Komisioni i Venecias, e të na thoshte që duhej me formë të prerë vettingu, që Këshilli pastaj të ndryshonte aktet nënligjore të tij. Ja, ky moment, a nuk tregon se sa “efikas” ka qenë Këshilli?! Më vjen keq, por duhet t’i themi gjërat ashtu siç janë. Po të kalojmë tek kandidati tjetër Vasil Bendo. Edhe për këtë kandidat në 20.01.2020, ka përfunduar hetimi ose administrimi i të dhënave nga institucionet e treta. Për kandidaten Vjosa Bodo Mujo ka përfunduar hetimi 21.11.2019. Për kandidati tjetër Envi Hicka, KED në datë 21.01.2020 ka pasur komunikimin e fundit, ndërkohë që u fut për shqyrtim në mbledhjen e KED më 17.07.2020, dhe 2 orë para mbledhjes paraqet kërkesë për dorëheqje. Nëse këto çështje që janë mbyllur me hetimin administrativ në Dhjetor 2019 apo maksimalisht në shkurt 2020 do të ishin futur në shqyrtim në periudhën Shkurt-Mars 2020, ndoshta z.Hicka do e kishte paraqitur dorëheqjen që në Shkurt-Mars dhe ne do të kishim pasur mundësi, ne dhe Kuvendi flas, që t’i riçelnim për aplikim këto vende vakante në kohën e duhur, sepse në garë në atë moment pas shqyrtimit nga KED-ja të këtyre gjetjeve do të na ngelte vetëm znj.Panajoti, e cila ishte tashmë e kualifikuar. Sot ndoshta do të kishim Gjykatën Kushtetuese funksionale.

Kandidati Klodian Rado kandidat në vakancën e Kuvendit, edhe ky është tërhequr nga kandidimi në datë 18.11.2019 është tërhequr me e-mail. Po ky kandidat, pse nuk u fut menjëherë në shqyrtim në KED? Për kandidatin Ardita Arsula ka mbaruar hetimi në datë 4.12.2019, i janë kërkuar shpjegime nga KED në datë 12.02.2020 dhe ka dhënë shpjegime më 14.02.2020, ndërkohë që është futur për shqyrtim në KED në 17.07.2020! Ne si institucion kemi bërë një analizë të thelluar dhe kemi përmbledhur disa prej këtyre problematikave që unë parashtrova më sipër. Vërejmë se ka pasur elemente subjektive dhe nga ish-Kryetari i Këshillit. Unë nuk e di nëse relatorët aktualë (zonja Marku dhe zonja Dollani), a i kanë kërkuar ndonjëherë ish-Kryetarit të Këshillit z. Dvoranit, se: “Jemi gati për relativitet, duhet mbledhje Këshilli”, për këtë periudhë, nga janar e deri në mars 2020? Se për ata që kanë qenë në vitin 2019, unë nuk e di. Nuk e kam këtë informacion ndaj dhe s’mund ta them më shumë, por nëse kjo është e vërtetë, atëherë është çështje shumë domethënëse, që tregon qartë se ka pasur subjektivizëm dhe brenda Këshillit, mendojmë ne. Tani dua të kaloj pak tek situata pandemike që përmendet në informacionin tuaj....

Saida Dollani kërkon fjalën duke sqaruar se, para se të shkohet te pandemia, se është caktuar relatore për vakancën e Kuvendit me shortin e datës 15.01.2020. Dhe pse aktet kanë qenë pothuajse gati, sipas ndryshimeve që u bënë në rregullore, i është dashur kohë për ti verifikuar dhe konfirmuar ato. Ajo shprehet se ka punuar në mënyrë intensive dhe në datën 28.02.2020 të gjitha relacionet kanë qenë gati, duke i kërkuar kryetarit të caktojë mbledhjen. Nga kryetari i ka ardhur një e-mail, ndoshta u ardhur edhe të tjerëve, se në datë 06.03.2020 do të zhvillohej mbledhja për t’i shqyrtuar relacionet dhe se pastaj nuk e di se çfarë ndodhi që nuk u zhvillua, ndodhi dhe pandemia. Duke qenë e shqetësuar për mbledhjen e Këshillit ka kontaktuar disa herë për këtë qëllim por i është thënë se është pandemia.

Arta Marku merr fjalën duke u shprehur se edhe relacionet për vakancën e Presidentit, ku është relatore, kanë qenë gati para 6 marsit por se nuk e di seç ndodhi që nuk u zhvillua mbledhja.

Bledar Dervishaj falënderon të dyja relatorët për këto konfirmime dhe shprehet se këtu dalin në pah ato që sapo thamë. Subjektivizmi që KED e diskuton pa emër. Ne të Presidencës e kemi thënë

gjithmonë, me emra dhe me kallëzime penale. Nuk kemi hezituuar të themi se çfarë nuk ka ecur në këtë Këshill. Rezulton se edhe në Këshillin e mëparshëm, ku relatorët kanë qenë z. Roshi dhe pastaj z. Patriky i fundit më pas është shkarkuar. Pas paraqitjes së dorëheqjeve nga kandidatët, duhet të relatonin për ato gjetje që kishin administruar dhe çështjet duhet të hynin në vlerësim nga KED. Erdhëm prapë në muajin Mars 2020, dhe erdhëm prapë tek pandemia. Nëse do të flasim për pandeminë Këshilli nëse do të thotë se është penguar nga kjo çështje, ne mendojmë se nuk mund ta thotë ashtu kollaj. Se më parë KED do të duhet të analizojë dhe krahasojë se cilat ishin efektet e aktit normativ të nxjerrë nga ministri i Shëndetësisë për situatën pandemike përkundrejt veprimtarisë së KED-së? Kur janë botuar këto akte në Fletoren zyrtare? Sepse janë dhe këto çështje që nuk janë detaje të vogla. Nëse do t'i hymë me themel, t'i hymë me themel. A e pengonte ndonjë nga këto urdhra të ministres së Shëndetësisë veprimtarinë e Këshillit? Nuk mund t'i hidhen pandemisë vonesat. E them këtë sepse gjatë periudhës së pandemisë institucionet kanë funksionuar, nuk është se nuk kanë funksionuar. Nuk ka funksionuar Këshilli, se s'e ka thirrur ish-kryetari. Se institucionet kanë funksionuar. Në datën 10 mars janë bërë emërimet nga Presidenti të 3 anëtarëve të rinj në Gjykatën e Lartë. Në datën 13 mars janë bërë betimet. Në datën 25 mars 2020, është zhvilluar mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare, organi më i lartë me certifikimin "sekret shtetëror", virtualisht, ku kanë marrë pjesë të gjithë. E them këtë për krahasim për Këshillin sepse është përmendur si argument situata pandemike. Është zhvilluar një tjetër mbledhje e Këshillit të Sigurisë Kombëtare më 15 prill, po virtualisht, sepse kam qenë vetë prezent në këto dy mbledhje me linja të certifikuara. Këshilli (KED) nuk mund të thotë që do shkelte detyrimin ligjor, se mbledhja është e mbyllur. E të çfarë informacioni?, të një mbledhje që përmbledhjen e procesverbalin e bën publike pas një jave?! Kështu që kanë qenë të gjitha mundësitë për t'u mbledhur Këshilli e të vendoste nëse nuk kishte kohën para fillimit të pandemisë, gjithmonë në vlerësimin tonë. Pra ka qenë koha e mjaftueshme që të gjithë kandidatët për këto dy vakanca të parakohshme (një e Presidentit dhe një e Kuvendit) të shqyrtoheshin shpejt, pasi nga informacioni që kishin administruar relatorët që i kishin gati që në fund të muajit shkurt 2020 kuptohej që këto dy vakanca do të shkonin drejt shuarjes (rishpalljes), dhe ne si organ emërtese (President dhe Kuvend) do të rihapnim garën, dhe sot mund të kishim kandidat. Ka humbur goxha kohë. Do të bëja një analizë dhe më të thelluar, zonja Kryetare, por ndoshta ky informacion duhet plotësuar edhe pak me tepër. Jam dakord me propozimin e një prej anëtarëve të Komisionit që raporti vjetor i veprimtarisë duhet të citoj të gjitha. Le t'i evidentojmë, në mos me emra, me struktura përgjegjëse. Kush e ka përgjegjësinë, e ka. Po jo të anashkalohet në informacion. Në vlerësimin tonë të deritanishëm ende jo të plotë, sepse analizimi i kësaj situatë vazhdon, kjo çështje nuk do të lihet me kaq. Ne nuk do ta lemë me kaq, sepse përgjegjësia është e madhe dhe një pjesë e përgjegjësisë u pa se kush e ka. Megjithatë unë u mora në fillim, por kjo çështje do të doja të kalonte në fund të rendit të ditës sepse Këshilli sot duhet të fokusohet më shumë tek ajo që është e rëndësishme – shqyrtimin e 6 kandidaturave që ka në shqyrtim, që të informohemi nëse do të ketë Presidenti kandidat apo jo? Faleminderit.

Vitore Tusha merr fjalën dhe shprehet se materialin e ka përcjellë si informacion, duke vlerësuar se kjo ishte mënyra më e mirë për tu informuar të gjithë mbi mënyrën se si ka ecur procesi. Ajo shprehet se nuk i ka emërtuar shkaqet, arsyet apo faktorët e çfarëdolloj natyre kanë qenë dhe se jo se ka pasur pengesë për të bërë vlerësimin e saj por se përgjegjësitë janë të përcaktuara me ligj. Në situatën e pandemisë u tentua dhe pati mbështetje për ta bërë mbledhjen *online*, por nuk garantohej që ajo të ishte e mbyllur dhe në këtë kuptim nuk mund të shkelej ligji. Sipas specialistëve nuk ruheshin karakteristikat

e mbledhjes së mbyllur nëse bëheshin mbledhje *online*. Në lidhje me relatorët shprehet se të tria ato janë caktuar me shortin e datës 15.01.2020, dhe që në atë moment kanë pasur përgjegjësinë për të verifikuar aktet e bëra dhe nëse kishte nevojë të ribëheshin ato. Shprehet se sugjerimet e mbledhjes do të përfshihen në raportin vjetor dhe se, duke pasur parasysh shqetësimin e madh të të gjitha institucioneve në lidhje me këtë proces, në këtë mbledhje u parashtruan për të marrë mendimet e të pranishmëve, në lidhje me masat që mund të merren për të qenë Këshilli më efikas dhe më efektiv në periudhën që ka mbetur.

Bledar Dervishaj shprehet: “Nuk ka asnjë koment për këtë znj. Kryetare. Presidenti i Republikës, Avokati i Popullit, përfaqësuesi i Kuvendit siç dhe deklaruan do ta mbështesin këtë proces, të gjithë. Si përfaqësues i Presidentit deklaroj se do ta mbështesim Këshillin në vijimësi siç dhe e kemi bërë, deri në datën 31 dhjetor, moment ky kur ka ditën e fundit të mandatit ky Këshill, se pastaj do të mbështesim Këshillin tjetër që do të krijohet. Nga ju ne presim impenjim maksimal, atë që kemi parashtruar edhe në shkresë. Nuk kemi thënë apo kërkuar ndonjë gjë, përveçse impenjim të pandërprerë të KED-së, për këtë që po ndodh sot, që me sa po shoh unë, do të duhet përfundojë procesi i verifikimit dhe kalimit pa vonesë në fazën tjetër- atë të vlerësimit, dhe për dy vakancat e tjera të shpresojmë të kemi një kandidat. Një impenjim të pandërprerë të KED kërkojmë. Kaq kërkojmë, vullnet”.

Saida Dollani kërkon të mbahet në konsideratë dhe të thuhet në raportin përfundimtar se rregullimet e akteve nënligjore, të bëra në muajin Shkurt, kanë vendosur detyrimin që relatori duhet ti konfirmoj veprimet e mëparshme për të mos ta nisur punën nga e para.

Marsida Xhaferllari shprehet në lidhje me mbështetjen e KED-së nga administrata e Gjykatës së Lartë, duke sugjeruar që, në mënyrë që mbështetja të përmirësohet, duhet që ekspertët e IT të Gjykatës së Lartë të bashkëpunojnë me Kuvendin dhe me Presidencën për të identifikuar platformën e përshtatshme që garanton zhvillimin e mbledhjeve online të sigurta.

Bilbil Mete merr fjalën duke u shprehur se duhen vënë pika mbi “i” për personat që bëhen pengesë. Në rast se KED-ja i drejtohet organeve përkatëse ato nuk mund të vlerësojnë njësoj certifikatën e sigurisë për anëtarin e KED-së ashtu edhe për një person tjetër dhe komunikimi është jashtëzakonisht i domosdoshëm që ata të veprojnë menjëherë. Punonjësit e institucioneve mund të mos bëjnë përpjekje dhe për dy vjet dhe KED do të vij vërdallë në rreth vicioz.

Vitore Tusha ndërhyr duke u shprehur se nuk ka qëllim të mbrojë asnjë institucion por se ajo vetë ka komunikuar me drejtuesit e institucioneve dhe komunikimi ka qenë shumë i shpejtë, çka del dhe nga shkresat. Edhe përgjigja e Prokurorisë së Përgjithshme ka qenë e vonuar por nuk ka qenë ajo pengesa. Pajisja me certifikatë sigurie ka qenë çështja më e rëndësishme për të cilën ka ardhur vonesa, ndaj vetëm në fillim të shtatorit relatorja ka mundur të shikoj dokumentacionin që ishte konfidencial dhe nuk mund të shihej më parë nga askush dhe se shkresa konfidenciale nga SHCKB-ja ishte për të gjithë anëtarët.

Saida Dollani shprehet se duhej të vinin që në fillim për shkak të ligjit.

Marsida Xhaferllari shprehet se vlerëson se z. Mete, ka një farë të drejtë në kuptimin që këtu ka një nevojë që të gjitha institucionet të bashkëpunojnë të jenë të qartë për metodologjinë dhe për ecurinë e procesit, duke shmangur përgjigjet formaliste, që pengojnë veprimtarinë e KED-së dhe përgjegjësia i mbetet KED-së. Në situatën kur KED-ja nuk ka strategji komunikimi me publikun, siç e kanë aktorët e tjerë, është e rëndësishme që Këshilli të identifikojë përgjegjësitë e kujtudo, edhe

përgjegjësitë e vetë anëtarëve të tij, jo për t'u shmangur nga përgjegjësia, por me frymën që të rregullohet çdo gjë që është e mundur.

Bilbil Mete ndërhyr duke u shprehur se ky është një problem i diskutuar që disa institucione shënojnë në krye të shkresës formalisht informacioni i klasifikuar, por kjo mund të zgjidhet me një takim.

Bledar Dervishaj parashtron duke iu referuar materialit se problematikat si më sipër do të jenë pjesë e raportit vjetor në këto mbledhje janë thënë këto problematika në këtë kuptim këta përfaqësues që i jep përgjigje Avokatit të Popullit, Presidentit, Kuvendit, kanë pasur informacionin e duhur të mjaftueshëm me procedurat e ecurisë të ndjekura nga KED-ja, kanë pasur mundësinë për të kërkuar çdo informacion shtesë në lidhjet me çështjet që vlerësojnë me rëndësi. Kjo duhet rregulluar, sepse, për shembull, ne e kemi marrë vesh në 16 shtator 2020 që disa nga anëtarët e KED-së, jo të gjithë janë të certifikuar nga DSIK-ja. E thatë ju si zv/Kryetare. Apo mbi ecurinë e proceseve e kemi marrë vesh në 13 korrik 2020 kur na erdhën relacionet. Është kështu? Kështu është.

Vitore Tusha ndërhyr duke u shprehur se të ftuarit kanë qenë të pranishëm në mbledhje dhe mund të parashtronin komentet në lidhje me ecurinë e vakancës, pra kanë pasur dijeni për procedurën.

Bledar Dervishaj thotë: “Kemi qenë në dijeni jo të ecurisë së procesit, se ashtu e lexon publiku, por ka ca që e lexojnë mirë, më mirë se ne këtu. E dinin këta që është vonuar... Jo jo! Ne e morëm vesh se çfarë kishte ndodhur me këto vakanca e me këto fakte në 13 Korrik 2020, se kjo është e vërteta. Dhe pyetja e fundit, ky informacion do të jetë publik i përgatitur nga ju si zv/Kryetar apo do të miratohet nga Këshilli dhe bëhet publik? Apo do na vijë ne si një kthim përgjigje? Se nëse na vjen, ne si përgjigje, ne që sot e vlerësojmë si të vogël pak të ngushtë. Ta sqarojmë këtë fakt”.

Vitore Tusha shprehet se duke ndarë shqetësimin e Presidentit, si edhe Kryetarit të Kuvendit është përpjekur që në informacionin e paraqitur ti parashtrorj të gjithë faktorët që kanë ndodhur dhe të ketë një dakordësi nga Këshilli, si dhe të marrë sugjerime nga anëtarët për gjëra të rëndësishme, siç është mënyra e komunikimit me institucionet.

Bledar Dervishaj shprehet: “Një sugjerim të fundit kam. Në qoftë se Këshilli, ne si institucion do ta bëjmë vetë, konstaton fakte që përbëjnë shkaqe që çojnë në lindjen e procedimit disiplinor për anëtarët e Këshillit, apo ish-anëtarëve duhet ta vlerësojë. Ne do ta bëjmë këtë vlerësim. Ky është sugjerim për Këshillin. Në rast se lind, apo evidenton lidhjen me faktet, që kanë dhe elementë të shpërdorimit të detyrës nga institucionet e tjera që vonojnë pa shkak informacionin ndaj KED, kushdo qoftë, edhe në këtë vlerësim do ta bëjmë deri në fund të mandatit të këtij Këshilli. Ky është sugjerimi ynë për Këshillin.”

Vitore Tusha kërkon mendim nga anëtarët.

Saida Dollani shpreh mendimin se përgjegjësia është e përcaktuar në ligj, ndaj në raport me ligjin nr. 115/2016 të shikohet përgjegjësia e gjithë secilit. Që Këshilli të dalë me një vendim duhet që patjetër të ketë një objekt shqyrtimi kurse këtu ka një rend dite që ka si objekt një informacion.

Marsida Xhaferllari merr fjalën dhe shprehet se, duke marrë në konsideratë situatën ku sot KED-së i është drejtuar gishti nga faktorët politikë, informacioni është një mjet i parë reagimi i Këshillit për analizën e situatës. Kërkon që Këshilli të fokusohet tek interesi parësor, duke mos i kthyer procedurat dhe mjetet e reagimit në qëllim parësor. Qëllimi i ekzistencës së Këshillit është shqyrtimi i kandidaturave dhe kalimi i tyre tek organet e emërtesës. Uron që në mbledhjen e sotme Këshilli të përfundojë shqyrtimin e kandidaturave për vakancën e dhe të kalohet tek procedurat e pikëzimit. Thekson se ky duhet të jetë fokusi kryesor që nga sot e në vijim, të mos ketë asnjë vonesë. Sugjeron që

nëse ligji dhe rregullorja thotë brenda 5 ditëve, Këshilli të veprojë që të nesërmen, për të treguar që ka energji dhe ka vendosmëri për të vepruar sa më shpejt. Përsërit që sa i takon marrjes së masave, momenti i hartimit të raportit vjetor është momenti i duhur për të reflektuar dhe për t'i ndarë. Këshilli duhet të pranojë se çfarë nuk shkoi mirë në Këshill dhe përse; shkaqet kryesore të vonesave siç janë paqartësia e ligjeve dhe akteve nënligjore, bashkëpunimi me institucionet, problemet individuale. Evidenton se çdo anëtar i Këshillit është zyrtar shtetëror dhe duhet të ketë kurajon t'i thotë problemet ashtu siç janë dhe të kërkojë marrjen e masave, duke pasur gjithmonë në fokus arritjen e qëllimit. Shprehet se në këtë tryezë të gjithë anëtarët i bashkon një qëllim: si të bëhet Gjykata Kushtetuese sa më shpejt funksionale. Thekson se duhet shmangur qasja për t'i ngecur përgjegjësitë njëri-tjetrit, përkundrazi secili të marrë përgjegjësitë përsipër dhe të përmbushë detyrat e tij/saj sa më shpejt.

Saida Dollani merr fjalën duke u shprehur se ligji ka parashikuar shkeljet disiplinore gjatë ushtrimit të detyrës dhe se në bazë të këtij informacioni të dhënë nga zv/Kryetarja të vlerësohet nëse ka nevojë të zbatohet neni 242 i ligjit nr. 115/2016.

Vitore Tusha ndërhyt duke thënë se Këshilli nuk duhet të çfokusohet nga fokusi i rëndësishëm, që është ushtrimi i detyrës funksionale kurse çështjet do të vazhdojnë të shqyrtohen më të njëjtin vullnet.

Bledar Dervishaj shprehet se Këshilli duhet të jetë i fokusuar te verifikimi i kandidatëve dhe se fokusi i kësaj mbledhje duhet të ishte verifikimi i kandidaturave.

Vitore Tusha thekson se ky do jetë fokusi i mbledhjes dhe propozon që të bëhet një pushim i shkurtër.

Rifillon mbledhja. Janë larguar anëtarët zëvendësues të Këshillit dhe përfaqësuesja e OPDAT.

Vitore Tusha vijon mbledhjen me pikën e dytë të rendit të ditës, që janë gjetjet për secilin kandidat që kanë shprehur interes për vakancën që ka shpallur Presidenti i Republikës në Nëntor të vitit 2019 dhe i jep fjalën relatores.

Miranda Andoni merr fjalën dhe fillon relatimin sipas radhës së përgatitjes dhe dorëzimit të relacioneve. Në lidhje me relacionin për kandidatin Sergio Mazreku relaton se ai është përfunduar dhe është dorëzuar pranë zv/Kryetares të KED-së në datën 28.09.2020 dhe në datën 29.09.2020 i është komunikuar kandidati. Data e mbledhjes 05.10.2020 dhe relacioni në lidhje me gjetjet në procedurën e verifikimit të kësaj kandidature janë dorëzuar të gjithë anëtarëve. Relatorja lexon relacionin në lidhjen me procedurën e verifikimit të kësaj kandidature.

Vitore Tusha pyet anëtarët nëse kanë pyetje, komente, ose sqarime.

Saida Dollani kërkon që relacionet bashkë me aktet e ILDKP-së, për ekonomi procedurale dhe të kohës të parashtrihen në mënyrë të përmbledhur dhe të shqyrtohen të gjitha pasi janë njohur me të gjitha aktet.

Vitore Tusha pyet nëse ka pyetje apo komente nga Avokati i Popullit.

Enio Haxhimihali merr fjalën dhe shprehet se nuk ka lidhje vetëm me këtë kandidat por dhe me dosjet e tjera të dërguara në institucionin e Avokatit të Popullit. Është vënë re që, ndoshta për shkak të ngarkesës, nuk arrihet dot që të vihet në dispozicion i gjithë informacioni. Për shembull, në rastin e këtij kandidati, në relacion thuhet që në datën 25 shtator kandidati ka bërë me dije Këshillin se i ka paraqitur pretendimet me shkrim në 11 mars dhe nga KED-ja nuk është administruar. Ka administruar vetëm

dokumentet. Kandidatit i është lënë afat për shpjegimet të cilat sipas relacionit i ka depozituar në datën 26 shtator me e-mail, të cilin nuk e kanë në dosje. Dhe për kandidatë të tjerë ka mjaft dokumente që lidhen me vjetërsinë ose me notat etj. që këtij institucioni i mungojnë. Kjo do të evidentohet më mirë po të bëhet ajo që Avokati i Popullit ka kërkuar: inventari i dosjes së sjellë në institucionin e Avokatit të Popullit, pasi vazhdojnë të vijnë dokumentet pa inventar për kandidatët. KED-ja, brenda mundësive të saj duhet t'i mundësojë që edhe institucioni i Avokatit të Popullit të ketë informacionin e plotë.

Vitore Tusha e gjen me vend ndërhyrjen që ia ka evidentuar edhe vetë Avokates së Popullit dhe shprehet se pjesa më voluminoze e materialeve u është përcjellë që në fund të korrikut, që të kishit kohën e duhur. Në lidhje me inventarizimin e materialeve për shkaqe objektive nuk është bërë në këtë rast, por do bëhet sapo të kenë mundësi

Saida Dollani kërkon sërish fjalën dhe ngre çështjen e pjesëmarrjes në mbledhje të përfaqësuesit të Avokatit të Popullit. Sipas saj, duke pasur parasysh aktet e KED-së ato nuk lejojnë që Avokati i Popullit të përfaqësohet nëpërmjet përfaqësuesve në diskutimet gjatë vendimmarrjes kur të gjithë përfaqësuesit e institucioneve të tjera tërhiqen nga mbledhja.

Vitore Tusha shprehet se përfaqësuesi i Avokatit të Popullit ka autorizimin në mbledhjen e sotme.

Saida Dollani shprehet se duhet diskutuar nëse autorizimi i shtrin efektet dhe për pjesën e dytë kur të kalohet në votim. Duke pasur parasysh edhe rekomandimin e Komisionit të Venecias që solli ndryshimin e nenit 41/4 të Vendimit të Këshillit nr.4, i cili nuk lejon që Avokati i Popullit të përfaqësohet nëpërmjet përfaqësuesve, vlerëson se përfaqësuesi i Avokatit të Popullit nuk mund të marrë pjesë në pjesën e dytë të mbledhjes kur të gjithë përfaqësuesit e institucioneve të tjera tërhiqen.

Vitore Tusha kërkon mendim lidhur me praninë e përfaqësimit të Avokatit të Popullit në procesin e vendimmarrjes.

Anëtarët e Këshillit, pas diskutimeve, u shprehën se Avokati i Popullit mund të përfaqësohet me përfaqësuesin e tij të pajisur me autorizim. Votuan pro anëtarët: Arta Marku, Miranda Andoni, Ludovik Dodaj, Fatjona Memçaj dhe Vitore Tusha. Votuan kundër anëtarët: Fiona Papajorgji dhe Saida Dollani.

Vitore Tusha fton relatoren të vijojë me relatimin për kandidatin Sinan Tafaj.

Miranda Andoni lexon relacionin përkatës të kandidatit Sinan Tafaj. Shprehet se ajo ka bërë një pasqyrë të fakteve për të t'u bërë të qartë anëtarëve se çfarë ka ndodhur deri në këtë moment. Sipas saj kandidatët që janë shqyrtuar njëherë nga KED-ja duhet të jenë objekti i vlerësimit edhe të konkluzioneve të mëparshme. Vlerëson se është e nevojshme të vazhdojë edhe me gjetjet e 2019 dhe krahasimet me përfundimet dhe shprehet se ka pasqyruar në relacion konkluzionet e aktit përfundimtar të 2020 në raport me gjetjet e vitit 2019.

Vitore Tusha pyet nëse ka ndonjë pyetje nga anëtarët.

Fatjona Memçaj pyet në lidhje me pretendimin e kandidatit për mospërfshirjen e deklaratës së datës 04.07.2020 në relacion.

Miranda Andoni shprehet se është pjesë e relacionit shkresa e datës 03.06.2019 e Shoqatës së të Verbërve të Shqipërisë dhe është e cituar. Ajo që nuk është cituar në relacion është deklarata e datës 04.07.2020 dhe kërkon që të bëhet pjesë e këtij procesi deklarata noteriale me nr. 1912 rep., nr. 75 kol., datë 04.07.2020 përpara noteres, të deklaruës A. B., i cili është një akt i ri dhe bën fjalë për një veprim juridik që kandidati ka shpjeguar në parashkrimin e tij.

Vitore Tusha pyet nëse Avokati i popullit ka ndonjë pyetje.

Enio Haxhimihali shprehet se nuk ka pyetje apo komente.

Vitore Tusha vijon mbledhjen me kandidaten Sonila Bejtja. I jep fjalën relatores Miranda Andoni.

Miranda Andoni lexon relacionin përkatës të kandidatit Sonila Bejtja.

Vitore Tusha pyet nëse ka ndonjë pyetje nga anëtarët.

Ludovik Dodaj ka një pyetje për kriterin ligjor, pasi profesioni i noterit nuk përmendet në ligj.

Miranda Andoni sqaron se kjo çështje i takon diskutimit të mëvonshëm dhe ajo se ka referuar gjetjet.

Saida Dollani pyet në lidhje me ndryshimet e referuara në relacion për të dhënat e gjendjes civile, ku bëhet fjalë për mbiemrin që ka mbajt.

Miranda Andoni sqaron se është i ndryshuar për shkak të martesës.

Fatjona Memçaj pyet nëse për periudhën prill 2001- janar 2011 është ushtruar funksioni i avokatit dhe nëse ka paraqitur kandidati dokumentacion, siç është regjistrimi në QKR, tatim-taksa për efekt të interpretimit të ushtrimit të profesionit dhe jo thjesht licencë.

Miranda Andoni sqaron se është e regjistruar dhe se dokumentacioni ndodhet tek akti përfundimtar i kontrollit të deklaratës së pasurisë. Rezulton se është e regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore me numër si person fizik me numër Nipt-i.

Vitore Tusha pyet nëse ka ndonjë koment përfaqësuesi i Av. Popullit.

Enio Haxhimihali shprehet se nuk ka pyetje apo komente.

Vitore Tusha fton relatores të vijojë me relatinin e kandidaturës së Shaqir Hasanaj.

Miranda Andoni lexon relacionin e kandidatit Shaqir Hasanaj. Relaton se përfundimi i relacionit i është komunikuar zv/Kryetares në datën 28 shtator 2020 dhe kandidatit i është komunikuar ky relacion nëpërmjet postës elektronike në datën 29.09.2020. Me marrjen e relacionit, kandidati i është drejtuar relatores dhe anëtarëve me një kërkesë për shqyrtim dokumentacioni. Relatorja lexon kërkesën e ardhur nga kandidati, i cili, në thelb, pretendon se në relacionin që i është komunikuar nuk janë pasqyruar provat e paraqitura prej tij dhe se nuk është marrë në konsideratë kërkesa e bërë me shkresën nr. 261, datë 14.09.2020. Kandidati ka kërkuar nga Këshilli të marrë pranë KLGJ-së procesverbalin e votimit të mbledhjes së KLD-së të datës 18.11.2016 në të cilën është votuar edhe ai si kandidat. Relatorja, në lidhje me këtë kërkesë, sqaron se në relacion është pasqyruar parashtrimi i kandidatit që komenton këto akte dhe se bashkë me parashtrimet ai ka depozituar edhe disa akte, të cilat i janë vënë në dispozicion të gjithë anëtarëve. Ajo shprehet se, pavarësisht se këto prova janë shqyrtuar në mbledhjen e mëparshme, është dakord që të pranohet kërkesa dhe aktet që kandidati i ka paraqitur bashkë me parashtrimet në datën 14.09.2020 të bëhen pjesë e këtij procesi dhe të shqyrtohen.

Saida Dollani pyet nëse këto akte janë paraqitur pas apo para relacionit.

Miranda Andoni sqaron se i ka sjellë në datën 14.09.2020 kurse relacioni i është dërguar kandidatit në datën 29, ndaj me të drejtë ai ka pretenduar që nuk janë pasqyruar. Në relacion janë pasqyruar tërësisht parashtrimi i kandidatit në lidhje me këto akte dhe kjo del edhe nga përmbajtja e relacionit.

Anëtarët diskutojnë në lidhje me këtë kërkesë të kandidatit Shaqir Hasanaj dhe shprehin qëndrimin se aktet e paraqitura janë të përfshira, por vetëm ekstremet e tyre nuk gjejnë pasqyrim të shprehur në relacion.

Enio Haxhimihali sjell një informacion para votimit, duke qenë se ka qenë në procesin gjyqësor të këtij kandidati, ku ka dëgjuar edhe pretendimin e tij, se pasi ka përfunduar relacionin, kandidati ka sjellë disa prova, të cilat nuk u morën në shqyrtim nga KED-ja, por janë përmendur vetëm në vendim,

kandidati e konsideronte këtë si shkelje. Pyet nëse të njëjtën gjë kandidati e pretendon edhe në këtë rast, pra nëse provat që ka sjellë janë apo jo në dosje.

Saida Dollani ndërhyr duke u shprehur se aktet në mënyrë indirekte janë përfshirë në relacion atje ku relatori i është drejtuar vendimeve të KED-së, si edhe në vendimin e Gjykatës së Apelit Administrativ. Në vendimin e mëparshëm të KED-së ato u përfshinë në shqyrtimin e KED-it dhe u bënë pjesë e vendimit ashtu siç kishte kërkuar vetë kandidati. Kandidati ishte shumë i qartë dhe kishte dhënë shpjegime shteruese. I quaj që janë përfshirë në relacion, por tashme të merren dhe të thuhet në mënyrë eksplicite aktet që po shqyrtohen. për dy arsye: së pari sepse duhen aktet që kanë vullë e institucionit dhe së dyti, sepse vetë kandidati në shpjegimet e tij pretendon që masa disiplinore i është revokuar për shkak të afateve shumë të gjata të marrjes së saj, ndaj pretendon se i plotëson kriteret për vlerësimin profesional.

Anëtarët e tjerë shprehen se janë dakord që të përfshihen aktet e kërkuara nga kandidati.

Miranda Andoni, lexon dhe rendit me radhë aktet e kërkuara prej kandidatit dhe të përfshira në këtë shqyrtim nga Këshilli, të cilat janë:

- rendi i ditës i mbledhjes plenare të KLD-së, datë 18.11.2016;
- raporti mbi rezultatet e shqyrtimit për kandidatëve për transferim apo emërim në pesë vende vakante në Gjykatën e Rrethit Gjyqësorë Tiranë;
- shkresë me nr. 4095 prot., datë 16.11.2016 i KLD-së;
- Procesverbali i KLD për mbledhjen e shqyrtimin kandidatëve për transferim në një vend vakant në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë që është shpallur me vendimin nr.115, datë 09.11.2016 i KLD-së;
- Procesverbali i mbledhjes së shqyrtimin kandidatëve për transferim në një vend vakant në Gjykatën e Rrethit Gjyqësorë Tiranë shpallur me vendimin nr.115 datë 09.11.2016.

Gjithashtu citon edhe aktet e tjera, pavarësisht se nuk janë kërkuar në kërkesë që janë:

- pasqyra e kandidatëve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë Tiranë 5 vende vakante të shpallur me vendimin nr. 115 date 09.11.2016.

Miranda Andoni vijon me parashtrimin e relatimit në tërësi për kandidatin Shaqir Hasanaj.

Vitore Tusha pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo sqarime.

Anëtarët shprehen se nuk kanë pyetje apo sqarime.

Vitore Tusha pyet përfaqësuesin e Avokatit të Popullit nëse ka komente.

Enio Haxhimihali shprehet se nuk ka komente apo sqarime.

Vitore Tusha fton relatoren të vijojë me relatimin e kandidaturës së Zhaklina Peto.

Miranda Andoni lexon relacionin përkatës të kandidates Zhaklina Peto duke u shprehur se ka pasqyruar edhe gjetjet e vitit 2019 në këtë relacion.

Vitore Tusha fton anëtarët nëse kanë pyetje apo sqarime.

Ludovik Dodaj pyet se çfarë ka ndryshuar ILDKPKI-ja dhe pse është në rregull tani.

Miranda Andoni sqaron se janë dorëzuar dokumente shtesë dhe se kandidatja ka dhënë deklarime.

Vitore Tusha pyet përfaqësuesin e Avokatit të Popullit nëse ka komente.

Enio Haxhimihali shprehet se nuk ka komente apo sqarime.

Vitore Tusha fton të vijojnë me kandidatin Eugen Papandile.

Miranda Andoni parashtron relatimin për kandidatin Eugen Papandile. Ajo shprehet se ky relacion u propozua prej saj të bëhej shtesë në rendin e ditës dhe kandidati ka qenë dakord. Ky propozim është pranuar nga KED-ja.

Vitore Tusha pyet anëtarët nëse kanë pyetje apo sqarime.

Anëtarët shprehen se nuk kanë pyetje apo sqarime.

Vitore Tusha pyet përfaqësuesin e Avokatit të Popullit nëse ka komente.

Enio Haxhimihali shprehet se nuk është në gjendje të japë komente për këtë kandidat. Shprehet se në lidhje me shtesën e rendit të ditës, duke qenë se dosjet e kandidatëve kanë mbërritur ditën e enjte të javës së kaluar së bashku me cd-të përkatëse, materiali ka qenë aq voluminoz, sa që duke qenë se ky kandidat nuk ishte parashikuar në rendin e ditës nuk është parë dosja e tij. Duke qenë se njoftimi nga ana e relatores dhe më pas njoftimi nga zv/Kryetarja është bërë ditën e premte dhe ka qenë ndërmjet e shtunë, e diel dhe sot është e hënë, nuk kanë pasur mundësi të njiheshin me dokumentet e këtij kandidati, ndaj dhe në fillim të mbledhjes u shprehën se rezervojnë të drejtën për të dhënë mendimin në një kohë të dytë.

Vitore Tusha sqaron se ka komunikuar me Avokatin e Popullit dhe e ka sqaruar në lidhje me numërtimin e materialeve. Sipas dokumentacionit që ka Këshilli, dokumentacioni edhe në lidhje me këtë kandidat i është dërguar me shkresë Avokatit të Popullit në datën 28.09.2020 me korrierin e Gjykatës së Lartë.

Enio Haxhimihali shprehet se për shkak të volumit është e pamundur që një person t'i shohë i vetëm, pasi hapet çdo dosje fletë më fletë. Duke qenë se nuk ishte i përfshirë në rendin e ditës, u la që kjo dosje të shihej kur t'i vinte radha dhe duke qenë se njoftimi erdhi të premten, pas orarit zyrtar, dhe nuk kishte më asnjëri, as dosje, etj. etj., ishte e pamundur që sot paradite të shihej kjo gjë.

Vitore Tusha pyet nëse do t'i konsiderojë të mbyllura shqyrtimet dhe të vijohet me vendimmarrjen e Këshillit.

Bledar Dervishaj kërkon fjalën dhe shprehet se: “Është bërë traditë që përfaqësuesit e Presidentit qëndrojnë vëzhgues, sipas ligjit, gjatë gjithë relatimeve që kryhen nga relatori. Ndoqem me vëmendje relatimet për të gjithë kandidatet dhe në këtë pjesë ne nuk kemi të drejtë të japin komente dhe gjetjet janë çështje që do të shqyrtojë Këshilli në seancën e tij të diskutimit dhe të vendimmarrjes. Falënderoj kryetaren në detyrë për angazhimin e treguar në 6-mujorin e dytë, pasi statistikisht shohim që veprimtaria e Këshillit është më aktive dhe shprehim dëshirën që kjo të vijojë në këtë drejtim. Këshilli, sipas nenit 149/1 të Kushtetutës, është autoriteti përgjegjës që do të kryejë verifikimin e kushteve ligjore dhe vlerësimin e kriterëve profesionale për të gjithë kandidatët. Kushtet janë si tek neni 125/3 i Kushtetutës dhe kriteret tek neni 7/a i ligjit nr. 8577/2000. Këshilli është në një moment që do të hyjë në një vendimmarrje, e cila është një vendimmarrje shumë e rëndësishme në disa aspekte. Jo vetëm për plotësimin e kësaj vakance që po shqyrtohet, pasi përmes vendimmarrjes së tij, Këshilli do të japë edhe një mesazh për publikun e gjerë dhe për kandidatët e tjerë që pritet të aplikojnë në vakancat e rishpallura tashmë. Ndaj vlerësimi me shumë pozitivitet dhe në mënyrë të arsyeshme i kushteve dhe kriterëve është i pritshëm në këto momente nga të gjithë. Mund tu sjell në kujtesë një shkrim të konstitucionalistes zonjës Aurela Anastasi ish-anëtare e Komisionit të Venecias, e cila para pak ditësh në gazetë, kishte publikuar një shkrim me titull “Asnjë minutë për të humbur për Kushtetuesen”. Në këtë artikull ajo citonte ndër të tjera masat që mund të marrë Këshilli ose organet e emërtesës dhe institucionet e tjera të përfshira në këtë proces. Konstitucionalistja dhe profesoresha e shquar citon shprehimisht në këtë artikull se: *“Nuk ka asnjë minutë kohë për të humbur... Një aspekt tjetër që lidhet me vlerësimin e përmbushjes së kriterëve ka të bëjë me testimin e kandidatëve: në kushtet që jemi, mendoj se nuk duhet të zgjidhet një “test strikt” i shqyrtimit të plotësimin të kriterëve, por një “test i arsyeshëm”.* P.sh., një

test i arsyeshëm mund të ndiqet nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi për llogaritjen e viteve të përvojës në punë...”.

Në përfundim z. Dervishaj i kërkon Këshillit të vijojë mbledhjen dhe të marrë vendimet e tij, në mënyrë që të ketë sa më shumë kandidatë për të zgjedhur dhe të kalohet më pas në fazën e vlerësimit, duke u shprehur se Presidenti i Republikës mbetet në pritje të një liste me kandidatë të mjaftueshëm për të ushtruar të drejtën e zgjedhjes.

Vitore Tusha deklaroi mbylljen e mbledhjes për të vijuar me pikën tjetër të rendit të ditës, procedurën e vendimmarrjes për kandidatët.

Mbyllet mbledhja në orën 19:15.

Tiranë, më 05.10.2020

SEKRETARE

ZËVENDËSKRYETARE

Elona KARDHIQI

Vitore TUSHA

Vilma DOKUSHI

Ermelinda KADIU

Dorina DULAJ